



Republika e Kosovës

Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog

Opština Istok
Istog Municipality

01 Numër:131/2018

Data:22.11.2018

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 44.1, 42 dhe nenit 54.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010,

T H Ë R R A S

Mbledhjen e **11^{-të}** e rregullte e Legjislacionit të VI^{-të} të Kuvendit të Komunës. Mbledhja do të mbahet më: **30.11.2018, e Premte**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë **në ora 10:00**.

R E N D D I T E:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019,
5. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

KRYESUESI I KUVENDIT KOMUNAL,
z. QAUSH BALAJ

Vërejtje :

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë,
t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL.

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e 10^{-të} e Legjislacionit të VI^{-të} të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 31.10.2018, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------|----------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 14. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 2. Zenel Shatri, LDK; | 15. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 3. Besa Ferati, LDK; | 16. Arben Kabashi, PDK; |
| 4. Naim Behlulaj, LDK; | 17. Ajshe Metaj, PDK; |
| 5. Luljeta Zeqiraj, LDK; | 18. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 6. Haki Podrimaj, LDK; | 19. Agron Avdiaj, VV; |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK; | 20. Lavdije Bujupaj, VV; |
| 8. Valbona Demaj, LDK; | 21. Arif Elshani, AE; |
| 9. Edona Lubeniqi, LDK; | 22. Radoš Repanović, SL; |
| 10. Naim Imeraj, AAK; | 23. Radenko Belošević, RB; |
| 11. Nexhmedin Balaj, AAK; | 24. Slaviša Maliković, SM. |
| 12. Muhamet Ukaj, AAK; | |
| 13. Eliot Kukiqi, AAK; | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Nënkryetari i Komunës z. Lulzim Blakaj, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

R e n d d i t e

6. Arsytimi i mungesave në mbledhje;
7. Miratimi i procesverballit nga mbledhja e kaluar;
8. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e tretë (korrik - shtator) të vitit fiskal 2018,
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për autorizimin e Kryetarit për nënshkrimin e marrëveshjes për klimë dhe energji,
10. Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullores për tatimin në pronë,
11. Miratimi i marrëveshjes për bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë.

Radoš Repanović, SL – përshëndet të gjithë, thotë se kanë dërguar në ilmall të Kryesuesi dhe në sekretarin e Kuvendit për një pikë të rendit të ditës, por nuk e kemi në këtë rend ditë që u prezantua.

Kryesuesi i Kuvendit – shkresën e kemi marrë atë që ju e keni kërkuar raportimi i zyrës së Komiteteve, ky raport është i përfshin në piken e tret të rendit të ditës në raportin financiar për tre mujorin e tretë të vitit fiskal 2018.

Radoš Repanović, SL – ne kemi të drejt të propozojmë në Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës kjo zyre duhet të raportoj, as një here udhëheqësi i zyrës për komunitet nuk ka raportuar në Kuvend. Kryetari na ka premtuar se do ta kemi një raportim nga kjo zyre pse ende nuk ka një raport.

Nënkryetari i Komunës – ky raport prezantohet për çdo raport financiar, prezantohet buxheti dhe planifikimi i të gjitha drejtorateve. Këtu nuk ka ndonjë problem. Udhëheqsi i kësaj zyre mund të jua përgatit në mënyre analitike çdo informacion që e kërkon.

Radoš Repanović, SL – unë flas për shefin e asaj zyre e jo për raportin aj duhet të raportoj para Kryetarit dhe para Kuvendit, jo të me raportoj mua por anëtareve të Kuvendit, kërkoj që raporti të hy në rend dite.

Nënkryetari i Komunës – unë e thash është shqyrtuar raporti tremujor i të gjitha punëve të komunës të gjithë drejtoret e rektorateve dhe shefi i zyrës së komuniteteve i kanë raportet, mundemi me qit në rend dite as një problem nuk e kemi, votoni do ta debatojmë raportin nëntëmujor për zyrën komunale për komunitete dhe as një telashe nuk e kemi.

Kryesuesi i Kuvendit – besoj që kjo është e qartë shefi i zyrës për komunitete është prezent këtu do të jetë edhe në të ardhmen.

Arben Kabashi, PDK – përshëndet të gjithë, kam 2 kërkesa: 1. Me sa kam marr informacion ajo krekës ka ardhur edhe te ju në zyrën e juaj sa i përket një mbështetje nga klubi hemollistik- Istogu ku nuk ka marr mbështetje nga Komuna në anën financiare, ata luajnë edhe lojëra ndërkombëtare, ne atë krekës e kanë parashtruar se nuk kanë mjete për mbështetje të ndeshjest që do të luhen e sidomos me 17.dhe 18.11. 2018 që kanë lojën me ekipe ndërkombëtare Italin, kërkoj që ajo krekës të hedhet në votim ku kërkesa ka shumen prej 7,500.00 euro vlera nuk është aq e madhe dhe është imazh për komunën që të mbështetet klubi hembollistik i femrave financiarisht që bënë pjese në kuadër të Komunës së Istogut, është krekës e vet klubit dhe e imja personalisht këtu, të gjindtë mënyra e financimit dhe të hidhet në votim kjo kërkesë, mënyra e financimit është shumë e lehtë, për shkak se është rast me emergjent për shkak se datat 17 dhe 18 janë shumë afër dhe duhen përgatitjet.

2. kërkesa e dytë kolega ose drejtori Enver na ka pru një plan të Veprimit të “Stacionit të Autobusëve” qe e kemi miratuar këtu në Kuvend dhe nuk ka pas nda mjete aty, krejt çka kisha kërkuar për shkak që kam edhe përgjegjësi shkarkimin e menjëhershëm të bordit të “Stacionit të Autobusëve”, që me i hapur rrugë të re zgjedhjes së bordit të ri edhe me e zgjidh mënyrën e financimit këtu faji është edhe direkt i drejtorit dhe përgjegjësi e vetë bordit pasi që është pjesë e menaxhimit të stacionit të autobusëve këto dy kërkesa të miat kisha pasur dëshirë të hedhen në votim.

Nënkryetari i Komunës – sa për njoftimin tuaj edhe të opinionit të gjere, klubi hembollistik është përkrahur në fillim të vitit me 6000 euro mjete financiare nga subvencionet tash së fundmi e kemi nënshkruar një vendim për blerjen e ndërresave dhe pajisjeve për klubin e hembollit si përkrahje nga Komuna e Istogut kjo vetëm se është në fazën e tenderimit të gjitha , klubi do të pajiset me ndërresa me trenerka dhe paisje që janë të nevojshme për gara. Po ju njoftoj me një rregullore nga Ministria e Financave ne po kemi probleme të përkrahjes së subvencionimit si klubeve sportive po ashtu të çdo organizate dhe jo qeveritare, për shkak se ne Rregullore është e precizuar që ndihma momentale mund ti epet vetëm në vlerë deri në 500 euro vlera tjetër mbi 500 euro duhet ti nënshtrohet konkurrimit ne duhet të shpallim një konkurs dhe përmes dëgjimit publik ne ti ofrojmë kushtet qe ne i kërkojm që ti përkrahim me një shumë ma të madhe se 500 euro këtu hyn edhe klubet e sportit sikur se të gjitha OJQ-et, kjo krekës do të realizohet edhe mos u marrte vendimi këtu se duhet të shpallet në pajtim me procedurat siç janë të parapara me Rregulloren për subvencionimin e OJQ-ve.

Sa i përket shkarkimit të bordit ju e dini që është formuar komisioni i aksioneve, ne mund ta debatojmë këtu si problem Stacionin e Autobusëve si pik të rendit të ditës dhe me ndërmarr së bashku me grupin e aksioneve dhe me ndërmarr hapat e nevojshëm dhe të

arsyeshme për funksionalizimin e stacionit të autobusëve, në bazë të atij plani operativ e kemi zgjedhur një inspektor të trafikut i cili sa kemi informata është duke e kryere disa veprime konform Rregullores për Trafikun në kuptimin e disiplinimit të kompanive që të respektojnë rregullat. Janë eliminuar disa mini stacione të rrezikshme në buzë rrugëve, të “Banana Center”. Nga drejtorati përkatës është duke u përgatitur rregullorja për trafikun komunal aty do të keni mundësi të debatoni për të gjitha çështjet por nuk e përjashtoj që me kërkesë të tuajën të hy në rend dite edhe debatimi rreth ecurisë së punës së “Stacionit të Autobusëve” atëherë inician edhe çështje të tjera normal në pajtim me ligjin.

Arben Kabashi, PDK – është kërkesë e imja me ua nda 7000 euro klubit hembollistik të femrave në Istog, nuk thash që komuna nuk ju ka ndihmua me 6000 euro ndonjë nderës ndonjë top apo diçka atë ngjashme çka ka në kuadër të klubit. Sa i përket veshjeve i kanë finasuesit e vetë bizneset që i përkrahin ato të paktat që janë, ata po kërkojnë me i subvencionu me pak mjete tek e fundit me 5000 euro për lojërat që i kanë pse mos të subvencionohet pasi që është imazh për komunën ky, kërkoj që të ju ndihmohet. Sa i përket “Stacionit të Autobusëve” besoj jemi të qartë, për me ndërmarr hapa ne jemi themelues Kuvendi është themeluesi dhe është përgjegjës për bordin dhe për menaxhentin kompletë të “Stacionit të Autobusëve” është e drejt e imja edhe me kërku me shkarkua për shkak të mos punës që e kanë ber ose në një forme e ka pru në kolaps menaxhmentin e komplet Stacionit të Autobusëve”kjo është, sidomos kërkesën e parë kërkoj ta përkrahni.

Nënkryetari i Komunës – Arben thash që ne klubin do ta përkrahim, në pajtim me Rregulloren së shpejti do të përmbushim kërkesat në bazë të Rregullores mbi përkrahjen e OJQ-ve edhe klubi së shpejti do të përkrahët me ato mjete bile së paku deri në 5000 euro për zhvillimin e garave normale që me të vërtet është krenari e komunës së Istogut, nëse tani marrim një vendim aj është jashtë ligjor dhe nuk është në përputhje me Rregulloren e Ministres së Financave për financimin e OJQ-ve, nuk po dua Kuvendin me bë me marr një veprimet tillë të jashtëligjshëm mirëpo le të jetë kjo si shtytje që ne ti përshpejtojmë ato procedura, kubi sa me shpejt të jetë e mundur do të përkrahët.

Naim Imeraj, AAK – desha ta them një mendim që e ka një logjik që këtij rendi të ditës në vazhdimësi i mungon një pikë e rendit të ditës ku do të trajtohen çështje të ndryshme ne ja kemi nis në rend të ditës të merremi me çështje pa pasur bazë. Praktika e herës së kaluar një pikë ku do ti trajtojmë çështjet kudo që si anëtar të këtij Kuvendi Komunal që jemi të rëndësishme e që kanë një peshë të rëndësishme të jetës së qytetareve të Komunës së Istogut, besoj që duhet me qenë edhe na kish nxjerr nga këto situata që në formulimin e rendit të ditës të merremi me çështje konkrete.

Agron Avdiaj, VV – Nënkryetar nuk e di aspektin ligjor për subvencionin po besojmë të ju dhe po presim. Jemi pas pajtuar që para miratimit të rendit të ditës të ngritën çështje ose pyetje në mënyra që të kalohet pastaj nëse kjo nuk është bërë pajtohem edhe me propozimin e Imerajt që të bëhet një pikë e rendit të ditës dhe të diskutohet pyetje dhe tema të ndryshme jashtë rendit që është e paraparë e aq me shumë sot po mendoj që nuk është shumë e ngarkuar edhe rendi i ditës kish pas mundësi ma shumë me u diskutu edhe ndonjë temë që kish pas dikush nga ne këtu. Shfrytëzoj rastin të i ngrisë do shqetësime dhe kush ka mundësi me i dhen ato përgjigje personat përgjegjës.

Kamë shumë ankesa nga qytetaret për deponon ilegale në Tuqep, sipas një raporti të Ministres së Ambienti dikund mbi 6mijë tonë në vitin 2017 janë grumbullua aty nëse

kësaj i shtohet se kjo është tu funksionu mbi 10 vite atëherë sasia e mbeturinave është duke u rritur vazhdimisht është bërë me qellim tranzitor është deponi e përkohshme vet fakti që ka kaluar mbi 10 vite pyetja që ish dashur me u shtrë sa është përkohshmëria e kësaj deponije, një arsyetim që është bërë pse është realizuar kjo deponi është kostoja e madhe e transferit të mbeturinave në deponi në Pejë mirëpo pyetja tjetër që shtrohet pastaj është se cila ka me qene kostoja bartjes së këtyre mbeturinave se prape këto duhet me u trajtu këto mbeturina sepse nuk mund të mbeten ashtu sepse rezultat i kësaj deponia nuk i ka ato parametrat vet fakti që është ilegale standardet për ruajtjen e ambientit është duke u kontamini toka vazhdon djegja e mbeturinave madje nuk ka pasur as kontaminim me dijen time që të ndalohej zjarri ka ankesa të mëdha të banoreve që duhet të mbrohen aty për shkak të tymit që ndodh në atë pjesë prandaj përveç kësajna, një fat ndoshta në këtë fatkeqësi të banorve të Istogut në kuadër të rajonit të Pejës janë që ka shtrirje me të ulet të mbeturinave 44% sepse po të ishte përfirja me e madhe e mbeturinave ajo deponi kishte me qen ende dhe ma katastrofë andaj e di që është duke u folur për një projekt që është duke u bërë në komunën e Klinës dhe të Istogut për një deponi të përbashkët në mënyrë që të kursehet aj fundi me investime me të pakta mirëpo është mirë me e ditë se ku është ky procese dhe sa do të zgjasë, sepse banoret janë të interesuar si do të bëhet zgjidhja e tyre.

Edhe një shqetësim tjetër para një kohe edhe mediat incidenti në fshatin Studenicë kinse vizita e pelegrinazhit i një grupi të komunitetit serbë, është shqetësim nga banoret e asaj anë. Nga muzeu i Istogut dhe nga institucione të ndryshme dhe instituti të Kosovës ajo kishë me dijen time është kish kristiane, është mirë që të bëhet një koordinim me i mirë nga Policia dhe institucionet që të parandalohen këto incidente, të kihet parasysh kjo të dilet me një komunikat që të trajtohet me me përkushtim kjo.

Nënkryetari i Komunës - është shqetësim dhe ka qen shqetësim jemi marr me problematiken e deponis tranzitore që është Toqep, ekziston deponia regjionale në Pejë për komunën e Klinës Istogut Deqanit, mirë po kostoja e dërgimit të mbeturinave atje është shumë e lartë është e vetmja zgjidhje prej të keqes e keqja me e mirë kjo deponi këtu ne kemi intervenu që këtë vit 20 mijë euro për rehabilitimin e asaj deponije është mbulu ajo pjesa me dhe është bërë një rehabilitim kogja i mirë personalisht kam qenë unë she drejtori më shumë here duke e përcjellore vazhdimisht që është kompania e cila kujdeset për mirëmbajtjen e kësaj deri sa në fund të dhjetorit kur i skadon edhe kontrata po ashtu për njoftimin tuaj nga drejtorati për shërbime publike i është bërë krekes ministrisë së planifikimit hapësitor në mënyrë që ajo të ndaj mjete në atë deponi të intervenohet dhe të rregullohet për shfrytëzimi si deponi transfere është angazhuar një punëtor së persona të pa përgjegjshëm duke e marrë mbeturinat atje ja kanë vu zjarrin asaj deponie dhe ka shkakut probleme për ata banorë, ne kemi intervenuar atje.

Kohet e fundit është i angazhuar një punëtor ton ditën me kontrate mbi shërbime të veçanta i cili do të kujdeset dhe është vendosur laura në hyrje të rruga kryesore që sado kudo atë deponi ta mbajë në gjendje të kontrolluar e dimë që nuk është e mirë po është e keqe me e mirë nga të kqiat, sa i përket shtrirjes së shërbimeve është e vërtet mirëpo të kishte qenë shtrirja e shërbimeve më e lart me përqindje me të lartë atëherë nuk kish pas deponi tjera mini deponi tjera po e kishim pasur vetë një vend të konceptuar si deponi transferi, tani jemi siç e dini në aksionin ta pastrojmë Kosovën ku është angazhuar edhe një kompani për eliminimin e deponive ilegale në ditën e caktuar do të angazhohen dhe do të ftohen te gjitha kompanitë private vullnet mirë që ti pastrojnë ato deponi ilegale ku janë të shpërndara në tere territorin e komunës së Istogut. Për deponin e përbashkët transfere është një projekt me GIZ-in, për ma shumë njofton drejtori.

Enver Rugova - Drejtor i shërbimeve Publike - faktë është se ka probleme në deponi në Toqep po mund me përgjegjësi të ju them është bere me shumë zhurmë pak politike të disa keqbërëseve se me ndërmarrjen e masave edhe nëpër mes polices dhe vendosjen e rojës aty që ajo u ndal edhe ata aktet me nuk po mund ta djegin, kemi të bëjmë me lloj lloj masave plastike e të tjera letra djegëse, mund të ju them më përgjegjësi së është nder tri deponit me të trajtuarat në Kosovë sepse ne me drejtor koleg takohemi në Asociacion te Komunave. Sa i përket deponive transfer dhe lejes së përkohshme ajo është normal e përkohshme mirë po ne kemi bërë krekës në Ministri edhe për ndihmë financiare dhe për vazhdimin e lejes për atë deponi ende nuk kemi përgjigje jemi ne lug të bisedimeve ministrin e kemi ftua këtu vet ta shehë situatën të gjitha parametrat e largësisë të vend banimeve tokave ju ka bere trajtimi do të jetë vjetor ajrosja kimike dhe biologjike që kërkohej me të gjitha normat e kemi përfunduar.

GIZ-i merret me kuadër të zhvillimit ekonomik dhe në kuadër të Ministres së Planifikimit Hapësinor me trajtimin e mbeturinave dhe brenda dy viteve sepse është diçka që kushton shumë që të ndërtohet një impiant i madh për deponimin e mbeturinave dikund në tremegjen Istog, Klin dhe Pejë kështu që të bëhet deponimi i të gjitha mbeturinave aty deponia në Tuqep vazhdimisht monitorohet, ruhet, kontrollohet tani në baza ditore ne me ata të komitetit kryesisht të Veriqit dhe të Bollopojës në baza ditore komunikojmë dhe tani djegje nuk ka apo ndonjë problem tjerët kesi soj, ka çështje të interesave aty për marrje të atyre mbeturinave lemenkave plastika etj po edhe ajo është duke u rregulluar kështu që nuk po e shohë ndonjë problem e kemi vendosur laurën është vendosur shtëpia e rojesë, roja është paguhet.

Agron Avdiaj, VV - ky trajtimi që i bëhet a është trajtim minimal që bëhet më bager mbulimi, pasi që nuk ka Izolim ajo ndotja e ujerave nëntokësorë. A dihet kur do të vjen projekti tjetër pasi që është thënë që kjo është e përkohshme po kjo i ka mbi 10 vjettë, ky është shqetësimi i banoreve se sa do të zgjasë kjo të qëndroj kjo deponi aty.

Enver Rugova - Drejtor i shërbimeve Publike - ju thash si na kanë premtu Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe në bashkëpunim me Gizin Gjerman para dy viteve nuk mundet me u zhvendos ajo dhe nuk mund të mbyllet ne i kemi pasur inspektoret e Ministrisë dhe kanë kërkuar mos me u hedh aty mbeturinat, deponia që është regjionale janë në Sferkë të Pejës ajo është stërmbyshur, me e vizitua është gjynah me e pa atë deponi dhe vazhdimisht hudhin aty mbeturina nga krejt regjioni i Pejës përjashtoj Istogun dhe deponija në Toqep është larg me e trajtuar dhe me e rregulluar se ajo ne Pejë ku është me leje të përhershme aty mbeturina nuk ka vend për tu gjuajtur, ne kemi qenë aty me kompaninë Ambienti të Pejës, edhe ata vetë janë ngush i kanë dergu në gjykatë Inspektoret e Ministris nuk kanë ata të ngratë çka me bë, që ne s'po i hedhim mbeturinat në Tuqep po i lemë nëpër qytet çka ndodhë nuk ka tjetër deponi në komunën e Istogut transfere që mund ta bëjmë, logjikisht me marr edhe gjeografikisht edhe në aspekt të fiksibilitetit, edhe për ujerat nëntokësor ki të drejt plotësisht sa ndikon ajo askush nuk mund ta dijë është vend se nuk ka frekuentim as njerëzve as kafshët shtëpiake, qentë s'po mund ti ndalim as ne se po i bien nga vendet tjera.

Jehonë Haxhiaj, AAK - pyet drejtorin e shëndetësisë a jeni i informuar së në QKMF-Rakosh ordinancën e stomatologut padisja e dentistit është e prishur dhe ky shërbim nuk mund të kryhet për qytetaret. Banorëve e atyre fshatrave kanë kërkuar nga unë që të parashtrij këtë problem për arsye se jo të gjithë i kanë mundësit me i vizitua ordinancat

private dhe kjo çështje është që tri javë e më shumë është absurde nëse nuk arrini me e zgjidh këtë problem.

Mujë Osmanaj - drejtor i shëndetësisë - ky është shqetësim me vende problem që duhet me u merr që i kanë ngarkuar qytetaret në një formë që të jenë përgjegjës pse nuk funksionon kjo pajisje, nuk jam i njoftuar që kjo nuk funksionon. Sanimi do të behet sa ma shpejt të jetë e mundur.

Naim Behlulaj, LDK - e kam një kërkesë edhe unë nga qytetaret për drejtorin e shëndetësisë kërkojnë që të jetë një ambulancë në QKMF në Rakosh. Janë përafërsisht 12 fshatra që shkojnë në atë qendër dhe kërkojnë që me e pas një ambulancë që ti transportojnë pacientet auto ambulancë për Istog.

Mujë Osmanaj - drejtor i shëndetësisë - nuk mund të jetë kjo fontan dëshirash.

Naim Behlulaj, LDK - nuk është fontan dëshirash porë është nevojë për qytetaret. Ne këtu jemi përfaqësues të qytetarëve me vjen keq që ne fjalorin e juaj gjindte kjo shprehje. Kërkoj interpretimin ligjor për këtë kërkesë.

Që me ligj i takon QKMF - Rakosh ni auto ambulancë pasi që janë 12 fshatra.

Kryesuesi i Kuvendit - ekzekutivi do ta ketë parasysh edhe detytori shqetësimin e juaj.

Mujë Osmanaj - drejtor i shëndetësisë - kërkoj falje për atë fontan dëshirash nuk ke direkt për ty ajo e terheku mirë po e njëjta kërkesë tani behet nga të gjithë dhe nuk ka mundësi.

Besa Ferati, LDK - QKMF-Istog nuk është e furnizuar ende me filma të rëntgenit që një kohë ka mungesë ku qëndron problemi, a kanë ardhur filmat apo ende nuk kanë ardhur.

Mujë Osmanaj - drejtor i shëndetësisë - është kryer ri tenderimi e ka fitua dikush dhe i ka sjell 100 filma sa për të filluar e biseduam edhe me Edonen si shqetësim këtë ky problem do të zgjidhet dhe për gjithë vitin e ardhshëm nuk do të ketë mungesë.

Muhamet Ukaj, AAK - ende pa hy në mbledhje ne kemi hyrë ne diskutime tjera e përkrahi idenë që te kemi një pikë të rendit të ditës që kur të diskutohen çështje të tjera. Shqetësimi në fshatin Kalibanë kam presion nga qytetaret se çka është bërë me kanalizim apo çka do të bëhet me ato mjete që janë të dedikuara për kanalizim ju lutem një përgjegjës nga drejtori përkatës ose tani ose më vonë pas takimit.

Naim Imeraj - me respekt të plot ndaj të gjithë kolegëve që sot e murrën fjalën pa filluar rendi i ditës për të gjitha çështjet që u ngritën edhe për përgjigjet e pjesshme që u mundën po unë insistoj që sot ky Kuvend të përcaktohet që në rend të ditës ta ketë një pikë të rendit të veçante për çështje të ndryshme e cila sipas propozimit tim duhet të jetë në funde të rendit të ditës pas shtjerrimit të rendit të ditës kjo është propozuar dhe ka kaluar në komitet për politikë e financa ju lutem që këtë propozim timin ta qitni në votim dhe të jetë i tillë dhe i përhershëm.

Zenel Shatri, LDK - pajtona plotësisht me mendimin Naimit për arsye se ne ende nuk e kemi miratuar rendin e ditës jemi tu fol. Për pyetje e përgjigje mund ta parashohim një

pikë të rendit të ditës një pikë për çështje të ndryshme në fund a në fillim ku të dakordohet kuvendi e jo kështu që një orë dhe ende nuk kemi filluar.

Nënkryetari i Komunës - po e shfrytëzoj rastin po ju inkurajon të gjithë anëtarët e Kuvendit shfrytëzoni të drejtat e juaja në bazë të ligjit mbi vetëqeverisjen Lokale, Rregullores së Punës së Kuvendit në bazë të Statusit, që pyetjet që janë në interes të juaji drejt për drejt të informoheni nga drejtorati përkatës të gjitha çështjet që ju brengosin, nëse ju nuk jeni të kënaqur me përgjigjen nga drejtorati dhe anashkalim në kuptimin e dhënies së përgjigjes i drejtoheni Kuvendit dhe debatojmë këtu për çdo çështje që është për kuvend.

Zenel Shatri, LDK - pavarësisht kësaj që thate ju kërkoj që të ketë një pik të rendit të ditës të ndryshme a në fillim a në fund ta qesim në votim.

Kryesuesi i Kuvendit - Hedhim ne votim që kjo pikë të jetë pikë e fundit e rendit të ditës por lus anëtarët e Kuvendit që pyetjet ti përgatisin më shkrim që ekzekutivi të jenë me të përgatitur për përgjigjet .

Miratohet unanim

Hedhe në miratim rendin e ditës:

U vendos:

Miratohet unanim rendi i ditës

24 anëtar të Kuvendit prezent në mbledhje

Shqyrtimi i pikës 1.

Në mbledhje nuk mungon as një anëtar vetëm tre anëtarët e Kuvendit të cilët ende nuk janë zëvendësuar nga KQZ-ja për shkak se ende nuk janë petrifikuar anëtarët dhe ne jemi sot vetëm me 24 anëtar prezentë.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Arif Elshani, IQ - përshëndet të gjithë të pranishmit, ne jemi në legjislacionin e gjashtë mbledhja e 9 e këtij kuvendi që unë e kam shqetësim edhe herën e kaluar lidhur me procesverbalin z. Kryesues mbledhjen e korrikut, mbledhjen e fundit procesverbali dhe fjalimi im nuk është korrekt nuk është sipas bisedës dhe fjalimit time që kam pasur dhe unë jam i shqetësuar edhe pse herën e kaluar ju me premtuat që do te përmirësoni të korrikut nuk e përmirësuar, te mbledhjes së kaluar jo se nuk e përmirësuar po e bëtë edhe me keqe nuk e di për çfarë qëllimi ju e bëni këtë nuk kam pritur që ju ti bëni këto gjëra edhe pse në të kaluarën janë bërë dhe janë mbetur me poshtë për të vërtetuar procesverbalin real kam lyp cd-etë me siguri ju si keni këqyr hiq biseda ime në cd me procesverbalin nuk korrespondon unë mund ta quaj së ajo është e qëllimshme pasi që është hera e dytë dhe mund të quhet si procesverbal i falsifikuar ju z. Kryesues duhet të keni një gjë parasysh nëse jeni ulur në atë karrikë si parti politike ju duhet ti përfaqësoni

të gjithë në qoftë së një anëtar i kuvendit i shkruhet i lejohet qe procesverbali ti marr edhe dy faqe e procesverbali jem të jetë një gjysme mendoj që kjo është shkelje e rënd që ku i ki ligjin çka është shkelje po dua me ti citu, dy shkelje të kodit penal te Republikës së Kosovës qe do te thotë falsifikimi i dokumentit zyrtar me qellim a pa qellim ti e dinë por jam i shqetësuar pse ti e bën këtë kam pasur një respekt ndaj teje pse je tu e bënë këta nuk jam tu e ditë kjo është mbledhja e pare që po e them nëse edhe një here ngjanë qe të falsifikohet në këtë mënyrë procesverbali im fjalimi im do të ju drejtona organeve me qëllim se kryesuesi pse po e bënë a je tujë shërbye dikujt a çka je tu bënë dyta kuvendin e kaluar ju te gjithë e dini që e kemi pas një TV me vonës e pa vonës e kemi pas pse tash së bën kjo është në kompetencën e juaj z. Kryesues nuk ka TV, atëherë e keni dhen në ora 11 dhe e kemi parë duhet me e dhënë zyrtarisht Lulzm ku e kemi edhe unë pajtona po nuk e kemi ende nuk e kam pa ku është duhet me na dhen më shkrim. Këtu e ki edhe pajtohem edhe kjo është shkelja e dytë z. Kryesues qe je duke e bërë po me qellim. A pa qellim ti e dinë. Unë kërkoj si anëtar i Kuvendit që fjalimet e miya të jenë me kuptim jo të shkosh dikundë e të ndërrosh përndryshe ka vend ku kërkohet transparenca e llogaridhënia e të tjera nuk kam pritur që ju z. Kryesues e bëni këtë.

Kryesuesi i Kuvendit - sinqerisht po të them nëse ka lëshime në procesverbal do ta rregullojmë, unë kërkoj nga ju që ato lëshime ti shkruani dhe ja bashkëngjisim procesverbalit unë e di që mbledhjet e Kuvendit incizohen janë edhe transparente kemi edhe një kamera këtu dhe radion. Sa i përket hartimit të procesverbalit të jesh i sigurt se kryesuesi nuk e harton procesverbalin, prandaj ajo nuk është ashtu nëse keni vërejtje bëni vërejtjet, keni pasur vërejtje jua kam përcjellur përmes audio incizimit e kam incizuar edhe cd edhe të kom thirr me mor, nuk je ardhë se me ki than e kom marr incizimin a ka qen kështu anëtar i Kuvendit, dhe për këtë edhe një here po të them e di që kam kërkuar nga zyra e Kuvendit dhe zyrtaret e IT që tua përcjellin audio incizimin dhe e di qe u kanë dërguar audi incizimin e kini, nëse në proces ka mbetur diçka e keni të drejtën ta plotësoni ta shkruani ja bashkëngjisim procesverbalit nuk ka diçka të qëllim të këtu asgjë të jesh i sigurt.

Arif Elshani, IQ- shqyr që ka ardhur koha edhe po dimi me lexu edhe me ndëgju nëse audi incizimin ma keni dërgua e vërtet unë i kam marr nga cd-et dhe kam ber vëzhgimin nga ajo cd ti merre vetë, nëse nuk e përpilon ti je i detyruar me këqyr me kontrollua edhe kur ka nevojë me këqyr cd se çka ka të shkruar merre këqyrë shumë bukur se çka kam fol unë. z. Kryesues duhet të kemi një gjë parasysh që duhet të jemi të kujdesshëm dhe duhet të jemi të njëjte para ligjit dokumenti që ti ma ke bënë tash me të shkrua unë ty me letër me shkrim çka mete shkrua unë e shpreha shqetësimin tim ta kom shpreh edhe para një muaji qitu ki thanë e rregulloj nuk e ki rregullu tash tjetrën edhe ma zi e ki bënë ku është qëllimi ti e din por një gjë po te them për para përgjegjëses nesër vini ju si kryesuese edhe me ligj dhe me Status dhe Rregullore ju jeni përgjegjës për këto që ngjajnë pra kësaj radhe kam thënë me gojë dhe kërkoj që në të ardhmen të përpilohet procesverbali fjalimi im si i të gjithëve nuk po lypi ma shumë.

Kryesuesi i Kuvendit - edhe një here po të them procesverbalin nuk e përpilon kryesuesi procesverbalin e nënshkruan kryesuesi pas aprovimit në Kuvend procesverbalet e përparme i kemi aprovuar këtu dhe unë i nënshkruaj pas miratimit dhe këtë e aprovojmë në kuvend me vërejtje nëse ki vërejtje e jepi me shkrim i përpunojmë. Prape po të them vërejtjet deponoj me shkrim, nuk ka nevojë për me leshu mbledhjen në këtë mënyrë z. Arif mund të diskutojmë dhe ta zgjidhim këtë çështje

Arif Elshani , IQ – lëshon mbledhjen.

Ajshe Metaj, PDK - dëshiroj jashtë procesi, puna e mungesave në mbledhje arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi i Kuvendit - Ata që mungoj pa arsye dhe me arsye nuk paguhen.

Ajshe Metaj, PDK - përshëndet, puna e mungesave ndonjëherë edhe nuk jemi këtu sa ndikon me kanë e arsyeshme dhe e pa arsyeshme ju ma dhatë përgjigjen për procesverbal nuk kom diçka.

Zenel Shatri, LDK - në rregull ata që nuk marrin pjesë hiq po ata që po vine e po nënshkruhen e po shkojnë në shpi çka me be me ta duhet me vendos kuorumi për shembull po e dimi shumë mirë Arifi rrini veç pak dhe del Besa po shkojnë kjo këtu si e ka emrin po shkon, atëherë po shkojmë të gjithë propozoj që kuvendi të vendos ai që rrinë gjithë kohen ose më nderu kohen e nënshkrimit e jo me u nënshkrua e me shkua, unë vij nënshkruan dal në korridor hupi ku jon jo sot po për çdo mbledhje kërkoj me u debatua për këtë punë dhe me u vendos a do të jua arsyetojmë mungesat që rrinë dy dakikë e shkon apo hiq ose aj që s'po vjen është e pa drejt mos me ja arsyetua mungesën kurë këta këtu po janë e po qohet e nuk po i arsyetohet Arifi, Besa dhe kjo qika këto janë duke bërë shpesh kështu nuk e di pse po i mbani folni tanë janë duke i parë anëtarët e kuvendit që janë duke dalur për dy dakika duhet me ndërmarr masa ndaj tyre ose hëkjau mëditjet ose qite listën edhe një here ka fundi me u nënshkrua propozoj që kjo çështje të rregullohet. Kjo çështje të rregullohet në nivel kuvendi ndoshta pa marr parasysh se prej subjektit politik timit me së shumti po mungojnë, jam për me ndërmarr masa ndaj tyre.

Kryesuesi i Kuvendit - anëtarja e Kuvendit Zeqiraj erdh kërkoj leje e thirren se vajzën e ka sëmure për ata edhe ka dal. Besa tha kthena,

Naim Imeraj, AAK - shumë here kemi diskutuar edhe në legjislacionin e kaluar se çka ish dashur me përmbajt procesverbal shpeshherë kam qen kritik edhe unë po ka kohë që nuk merrna jo që nuk e lexoj po nuk merrna me tash drejtën kur e lexoj pjesën time unë e kuptoj po nëse shikohet prej prizmit të një qytetari të thjeshtë është vështirë e kuptueshme nëse nuk janë nda fjalitë nëse nuk ju ka dhen kuptimi në aspektin gjuhore për më e bë një gjë të tillë duhet me qenë njohës i mirë i materies e kuptoj dhe për ata e kam len, e lexon kushte e lexon nëse vërejtjet e Arifit janë se është tu u senzoru procesverbal pjesa e tij e diskutimit në vazhdimësi atëherë është shqetësuese nuk mund ta vlerësoj mund ta kërkoj vetëm pjesën që kam diskut vetë mirë është me u dokumentua në mënyrën më të mirë të mundshme për ata që e kanë interesin me e lexu ne jo prezencë atëherë kur i epet mundësia e di që janë transparente mund me hy çdokush me i pa procesverbalet procesverbalet janë të bashkëlidhura në faqenë zyrtaret te komunës po ish dashur të jetë edhe një filtër para se me ardhë të ne. Prapë përgjegjësia bie të ju që ju me e lexu një here atë procesverbal para se me e ardh te ne, bëni pak përpjekje që ta shikoni. Ne këtu jemi të gjithë poste politike dhe sa kemi interes me e zgjedh çështjen me shkua te drejtori po aq kemi interes me pas mediat që ne jemi te angazhuar pa përjashtime.

Kryesuesi i Kuvendit – të jeni të sigurtë që aty nuk ka cenzura ndoshta është ber ndonjë gabim që mund të përmirësohet.

Arben Kabashi, PDK - aspektin gjuhësor gjithë po kemi mangësi te fjalive nuk po dua me i cek në raport ka gabime që nuk i kam thënë ka mospërputhje te fjalive ose cakun që e kom thënë pajtona plotësisht edhe me kolegen Arif se po i bëhet censurimi ne e dimë çka ka fole, ose fjalitë e fundit ju ka qit në kryet ose ata të fundit se ka hiq domethënë po i bëhet një censurim i fjalive ose në vazhdim të proceseveverbaleve fjalimin e tij që ka ndodhur edhe në mandatin e kaluar këshilloj z. Kryesues të jeni me të kujdesshëm. Ndërsa sa i përket idesë së doktorit atje se e foli unë pajtona plotësisht me të se ka ndodhur edhe mandatin e kaluar por edhe këtë mandat sa i përket grupit të LDK- së nuk janë transparent i marrin mëditjet pa qene në mbledhje hiq, ose vin nënshkruhen kjo po ndodh që 9 mujë ditë, të jem me i sigurtë jem një përfaqësuesi i qytetareve pa dallime politike por edhe brenda një subjekti politik ndoshta.

Kryesuesi i Kuvendit – mëditje nuk ka marrur askush pa qenë në mbledhje të jeni të sigurtë për këtë. Lidhur me procesin e thash besoj që kesh i qartë, është e vërtetë duhet të prezantoj edhe procesi adekuat atë se çka thuhet këtu, jam plotësisht dakort por fatmirësisht e kemi edhe incizimin gabimet e lëshuara mund të përmirësohen mund të shtohenë.

Pasi që diskutime tjera nuk ka në lidhje me procesverbalin hedh në votim:

Kush është që të miratim procesverbalin me vërejtje,

Kuvendi i Komunës vendosi:

Miratohet procesverbalin i mbledhjes së kaluar me vërejtje shumicë me votave 19 për, 3 abstenim

22 anëtar të Kuvendit prezent në mbledhje

Shqyrtimi i pikës 3

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me piken e tretë të rendit të ditës Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e tretë (korrik - shtator) të vitit fiskal 2018;

Osmon Sadikaj, Zyrtar kryesor Financiar – prezantoi dhe sqaroi raportin financiar për tre mujorin e tretë (korrik - shtator) të vitit fiskal 2018,

Naim Imeraj, AAK - e kisha quajtur këtë raport nëntë mujorsh e jo tre mujorsh për shkak se materiali i dhen si i tillë jep mundësin për me e ber filtrim po realisht shumat i nxër si rekapitullimet janë rekapitullime të asaj që ka ndodhur nëntë muaj por të fundi nuk është me rendësi jemi ka shkojmë ka fundi i vitit dhe shpresoj që synimet i kemi të njëjta ngecjet po filloj nga të hyrat vetanake ngecjet nen programet ekonomike tatimi ne pronë deri me tani sipas kësaj se çka mund të nxirret nga informata përafërsisht 71% regjistrimi i automjeteve 80% që është një tregues i mirë lejet e ndërtimit mbi plan po unë gjithmonë kam thënë se jemi duke planifikuar pak jemi në të njëjte gjatësi valore me zyrtarin financiar dhe problemit i kemi në planifikim po arsyetohemi se kornizat po. Na bene Ministria e financave dhe kur po vimi ne raportime po del që problemin e njëjtë e kemi me sektorin e administratës më vazhdimësi kemi mbi planifikom edhe duket që nuk po arrihet por në vazhdim është mbi planifikim nuk munden zyrtaret ne ofiqari me diku numrin e aktiviteteve qe do ti keni por ajo është qështje e kërkesës së qytetareve nuk korrespondon me planifikimet qe i bëjmë ne si përmbledhje të hyrat vetanake 21 del në raportet me planifikimin e vitit që e kemi nuk po i them shumat po i them vetëm relative që me muajt me kalu me shpejt është rreth 72% që besoj që duke marr parasysh që vitin e

kaluar e kemi pasur një 80% një planifikim me të madh lë len vend që me besu se deri në fund të vitit nëse nuk e marrin qindpërqindshin do të jemi në 95% e tutje që është një tregues pozitiv po e marr gjithë në raport se çka bëhet me këto të hyra vetanake aq sa nuk mundemi mi arri me i mbledh projektet e pa realizuara qofte të mallrat dhe shërbimet qoftë të subvencionet ku e marrin një pjesë shumë të madhe qoftë të projektet kapitale qe janë direkt që e prekin qytetaret nuk them se shërbimet pjesën e shëndetësisë e preku zyrtari kryesor financiar nga shkëputjet që i kom bë unë po del që arsimi par fillor she qerdhër po ashtu e kanë një ngecje është një shifër e planifikuar 99 mijë e realizuar 49 mijë kisha dashur ta kem një përgjigje se çka po ndodhë është qesatje me çka? A është ndaluar raportimi, a është ra numri i fëmijëve që të cilave u jepen ato shërbime apo q far po ndodh.

Nuk do të isha marr në tonsi meqenëse ndërroj shifrën nuk është me shifra 760 e cila është raportuar në dokumentacionin po ka shkuar ne 859 si tersi që i jep edhe një element një informatë me rendësi që do me thanë synimet e këtij kuvendi komunal qe së bashku me administratën me ekzekutivin që të kemi përmbushje të planit do të jen për afërsisht të realizueshme.

Nga dokumenti i kontrollit buxhet financiar i kontrollit bëhen shërbimet ashtu siç i ka bërë edhe zyrtari kryesor financiar del që shpenzimet aktuali, po flas për raportin financiar të tre mujorshit të tret përkatësisht tre mujorëve të parë të këtij viti edhe del se nga të gjitha burimet e financimit, të gjitha kategoritë ekonomike prej mbi 10 milion euro janë realizua në tersi 49% aktuali shpenzime të hyrat vetanake s'po flas për paga pagat janë diçka qe rrjedh,

Ka participim edhe nga të hyrat vetanake e që e përmbushin dhe nëse e filtrojnë kategoritë ekonomike na del. Se mallrat dhe shërbimet janë në shpenzim 45% shpenzimet komunale 66% subvencionet dhe transferet 61,8% po flas në raport me planifikimet dhe pasurit jo financiare që po konsideroj që janë projektet kapitale 18,8% informacioni që 134 mijë respektivisht 135 mijë janë marr e janë trajtua si shpenzim difavorizon këtë shifër dhe bën në shifër e cila është edhe me e vogël 14,6% apo 15% është jo informacion për një dinamikë jo të mirë po besoj së këto informacione janë në anën e ekzekutivit i dinë e din problemet të cilat mund të rrjedhin nga kjo qe vitin e kaluar na ka ndodhur që faktikisht 20% e buxhetit na ka shkua në suficit edhe shpresoj bindshëm që janë duke u bërë të gjitha hapat e mundeshim që mos të na ndodh edhe këtë vite problematika që e përcjellë vitin e kaluar e mos realizimi të rishikimit të buxhetit edhe në këtë vit mund të ketë pasoja, po flas si një qytetar si një anëtar i kuvendit të komunës pa tendencën për diçka apo me i dhen vlerë të kundërt asaj donë edhe shumë pune po shpresoj që prej këtyre zotimeve dhe obligimeve në pritje që janë hiq pagat që janë rrethë 46% të buxhetit do të jetë një shume e mirë e që është në realizim e do te realizohet e kjo qe është buxheti ne fribalanc i lirë pre 25% po shkojnë po beso se deri ne funde të vitit nuk do të jetë i tillë po do të jetë një tjetër, me shpresën që do të jetë i nivelit minimal çka dua me than e çka me brengos është çështja e mjeteve të bartura nëse e marrim kategorinë 21 dhe 22 mjetet e alokuar jo te planifikuara dhe i bëjmë bashke vetëm 33% i kemi shpenzua a i ki pas në dispozicion prej vitit të kaluar 307mijë euro prej të cilave i kemi shpenzua vetëm 15% me të vetët kjo donë përgjigje. Të me epni një përgjigje. Po. Mund ta marr. Me. Mënd pse janë vetëm 40% të shpenzuara të këtij viti për shkak se dinamika vonesat të gjitha ato, po të viti të kaluar pse nuk keni mundur me i hargju të bën më u rikthy të dy elementët tha se është një dukuri për here të parë të këto shifra na u është paraqitur dukuria e përmbarimor normalisht edhe shpenzimeve që e terhjekun këtë përmbarim them që kemi vendime gjyqsore rreth 135 mijë eurove, mirë po këto vendime gjyqësorë shpenzimet që i kanë terhjekur janë 21.343,00euro në mallra dhe shërbime shpenzimet janë një projekt shumë i

mirë a po punojmë a po e bëjmë maksimumin që mos me i mbajt gjallë përmblyesit se kjo po doket si biznes. E koficieni i përmblyesve ish kogja i lartë dhe po shihet në shifër 135 mijë euro 21500euro

E dini në këto legjislacionet e kaluara kurrë nuk jam kap për elementin lugë dreka zyrtare në vitin 2017 kanë qenë 12 mije euro, pse sivjet janë 33 mijë në tre mujore jo në fund vit dhe nëse e kam gabim informacionin atëherë kisha pasur dëshirë mëm demantu.

Arben Kabashi, PDK - pak a shumë kolegu Naim i kalkuloj te gjitha por unë deshta me u ndal veç një pikë pra një sqarim mjetet te cilat janë ekzekutua kur te bëjsh një përmbledhje del dikund 119.439,00 euro borxhe te pa paguara te gjitha këto mjete kur ti kalkulojsh te gjitha del se përmblyesi privat i ka tërhyjek, o skandal për komunën tone për këtë tremujorësh e kom fjalën dhe pyetja është a ka edhe borxhe tjera në procedura që mundet përmblyesi privat me i tërhyjek, donmethanë komunës u janë ekzekutua 119.430,00 euro kur te mbledhësh totalin pa gjykata ato që i përmende janë borxhe të pa paguara kur te bëjsh një përmbledhje del kjo shumë a është skandal ky?

Agron Avdiaj, VV - pjesën me të madhe e përmendi kolegu Naimi që ndoshta nuk kisha qen e arsyeshme me hy me i përmend te gjitha në pika trasha i kam tri shqetësime

1.edhe tejkalimi i inkasimit ne sektor të caktuar konsideroj që është një lloj dështimi në planifikim edhe mos realizime madje edhe në vlera 0.8% në sektor të caktuar nuk është arritur realizueshmëria natyrisht edhe kur të behet planifikimi i buxhetit merret parasysh aj historiku i viteve paraprake pikërisht për me i minimizu këto anomali që po ndodhin konsideroj që këtu ish dashur me pas me shumë kujdes në planifikim elementi tjetër është planifikime mbi 10 milionë dhe realizueshmëria as gjysma e tyre nuk është bere deri me nëntëmujorin që e konsideroj pra gabim, po ashtu gjasën e tremujorit ka me u rritë ish dashur një shpërndarje pak me e madhe jo me i lan veç në fund të vitit edhe sigurisht se kjo çështja e mjeteve të marra nga përmblyesit për mendimin temë është shqetësuese e përmenden edhe dy koleget me herët se kjo pos këtij edhe në opinion edhe të ne si asamblisti jo vetëm të çështja e gabimeve mos ndjekja e procedurave po lenë që mund të bëhen edhe qëllimisht këto gjëra që pastaj të nxirren përfitime qoftë biznesore apo tjera.

Eliot Kukiqi, AAK - janë te planifikuara mbi 3 milion ndërsa janë shpenzuar vetëm 598.521,00 apo në përqindje 18.19% e shumes së dedikuar për shpenzime kapitale a ka mundësi deri ne fund vitit me u përmbush shumen e planifikuar?

Nënkryetari i Komunës - veç një përgjegje dua ta them sa i përket ekzekutimeve të përmblyesit nuk e di si ndaj neve menjëherë po na ekzekutojnë ne e kemi një lende ndaj Ministres së Bujqësisë ka që një vite 3000 euro na kanë borxhe e kemi qu në përmblyes dhe që një vit ende nuk ka asgjë personalisht jam shku në gjykata e kam gjetur lenden ton të komunës tonë të fundit, të gjitha procedurat janë krye krejt vendimet janë marr dhe ëndërr nuk ka asgjë. Kjo po ndodh te disa operator pasi që kontrata po skadon nuk po kemi mjete financiare me pagua po skadon kontrata për një ditë ne s'kemi mundësi me pagu atë borxhe për shkak se po thot nuk ka kontratë valide me to dhe nuk je i obliguar me ja pagu atë borxh edhe pse juridikisht një borxh i krijuar nga një raport kontraktues i ma hershem është valid mirë po të thesari kjo nuk zbatohet

Sa i përket shpenzimeve preje 33 mijë euro për dreka që është tejkalim në fillim te tre mujor shit kemi pagur borxhe nga obligimet e krijuara gjate vitit 2017 të cilat janë paguar menjëherë me alokimin e mjeteve, kanë qenë pasqyrat financiare ta paraqitura dhe kjo po e ngrit shpenzimin po ashtu po ju njoftoj se çka po e ngrit shpenzimin e ushqimeve edhe

klubi i futbollit i sigurojmë ushqime për çdo lojë që e zhvillon për çdo javë dhe hembollit ushqime që i kemi me kontrate në Troftën dhe kjo po i ngrit shpenzimet në kod ekonomik se këto nuk mund ti ndajmë janë në një kod dreka zyrtare 18% është shpenzimi i kapitaleve në kemi pasur vonesa në tender për shkak të një vonese e hartimit të projekteve detale në kapitale që është vonuar ende në ASHP-ja nuk ka vendosur se cilin operator me përzgjedh prej marsit e deri sot ende ASHP-ja nuk ka marr një vendim dhe ende jemi në dilemë për shpalljen e tenderëve për shkak të këtyre kriterëve që duhet për çdo tender të shpallur të ekziston edhe projekti detal, kur e kemi par që ka vonesa të mëdha atëherë kemi hy në përshkrime teknike të projekteve ekzistuese dhe i kemi shpall tenderët tani të gjithë tenderët e planifikuar sipas zyrës së prokurimit dhe tenderët për shpenzime kapitale janë shpallur janë në fazën e ekzekutimit tash pritet kur i realizojnë punimet dal ka dale t'ju kryhet edhe pagesa sipas garancinë vë të kryera.

Osmon Sadikaj - pjesa të arsimit planifikimi i participimit, ju e dini se në e kemi në Rregullore komunale e cila cakton tarifën e kopshtit të fëmijë nga prindërit, ajo është shumë e sigurt dhe derdhen në llogari. Ndalemi pak të keq planifikimi sigurish është ber keq planifikim paraprakisht duhet me e bë një analizë se sa mundesh me realizua kjo është çështje fikse sa prind i dërgojnë fëmijëve në shkollë aq edhe paguaj. I kemi edhe shtat apo tetë pozicione tjera që planifikime është 10 mijë euro që thatë po ndoshta realizimi është 5 apo 600 euro e thash edhe në fillim nuk kemi pasur kujdes në planifikim real se kemi tejkalime tani në fund realizojmë qind për qind të hyra vetanake po realisht në bazë të standardeve ndërkombëtare të financat nuk je në rregull me çështjen e planifikimit edhe pse paret janë mbledhur.

Naim Imeraj, AAK - me siguri me ke percjellur kur kam thënë se po i thirrëmi një kornize e cila po na imponohet prej nivelit të ministrisë se financave çka është fleksibiliteti ynë aty a është dembellëk i joni që nuk po i rishqyrtojmë këto planifikime apo me të vërtetë është kornizë që ka të bëjë me kodet ekonomike me programet dhe nën programet ekonomike.

Osmon Sadikaj - ministria e financave le të na cakton vetëm kufitë se sa na duhet me i mbledh të hyrat si total tjerat janë autonomia jon 100% cilat vende dojm me i realizua ato të hyra është autonomia jonë.

Çka të kini të pa qartë shkruani në imell kur doni ju jap përgjigje të gjitha janë transparente.

Borxhe tjera sigurisht që ka padit por atë informatë nuk e kamë por kur të vjen pasqyra financiare e ka rubrikën e veçante janë detyrimet kontingjente që janë të obliguar të gjitha çka kush na ka padit, nuk është me rendësi a fitohet kontesti ajo ne po na kërkohet rregulla financiare që ne me evidentë kush na ka padit dhe shumë sa pastaj kur të bëhet ekzekutimi, e kam prur para ju përmbaruesin edhe gjykatën para dy vitesh e kanë ndërru një kod ekonomik për të gjitha kategoritë ekonomike përmbarimet në gjykata apo përmbarues është një kod i veçante çdo kategori ekonomike, që do të thotë ata mund me na marrë edhe në paga kur nuk i gjejnë dikund tjetër edhe pagat i merr e ka marrëveshjen së pari na pyet se ku nuk dëshironi me i marr nëse nuk dërgojmë përgjegjës ku ti gjen i merr andaj e kanë qit kodin se kur të bëhen pasqyrat financiare çdo kategori ekonomike e kam obligim me sqaru pse e ke lejua me ardh deri të kjo pagës nga ky kod ekonomik është obligim ligjor e sqarojnë këtë. Të hyrat e bartura unë po mendoj edhe të hyrat vetanake që i kemi mbledhur në këtë vit rialokimi dhe prape janë të pa shpenzuara arsyeja është se këto nuk humbin. Mbetje këtë vit do të ketë me shumë për arsye se janë

shpenzuar vetëm pak mjetë. Sot është data e fundit që mund ti zotojmë mjetet nga kapitalet dhe shpallet tenderët, sipas raporteve që i nxjerra sot gjendja është mirë çdo gjë është zotu edhe shpallet tenderi.

Kryesuesi i Kuvendit – pasi që diskutime tjera nuk pati mendoj që debati është shtjerrur dhe kalojmë në piken e radhës së rendit të ditës
22 anëtar të Kuvendit prezent në mbledhje

Shqyrtimi i pikës 4

Kryesuesi i Kuvendit – propozon që të vazhdohet me piken e katërt të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për autorizimin e Kryetarit për nënshkrimin e marrëveshjes për klimë dhe energji, kjo pikë është propozuar në komitetin për politikë e Financa dhe rekomandimi është që kjo pikë të i kalohet Kuvendit për shqyrtim dhe Miratim ia kaloj fjalën Nënkryetarit.

Nënkryetari i Komunës – bëhet fjalë për një marrëveshje ndërkombëtare për Klimë dhe Energji. Kryetari i Komunës z. Haki Rugova ka qene pjesëmarrës në një konferencë të organizuar në Vjenë, aty ka pasur shumë Kryetar të komunave nga mbarë bota ka qene konferencë me karakter global ku është nënshkruar një marrëveshje për ndryshimet klimatike, sipas kësaj si kuvend duhet të marrim vendim për autorizimin e Kryetarit për nënshkrimin e kësaj marrëveshje dhe koordinator për këto është Osmon Sadikaj ku para jush do ta sqaroj marrëveshjen.

Osmon Sadikaj – zyrtar kryesor financiar- prezantoi dhe sqaroi Propozim – Vendimit për autorizimin e Kryetarit për nënshkrimin e marrëveshjes për klimë dhe energji,

Naim Imeraj, AAK - përbërjen e materies nuk kemi së çka me fole bota është duke i bartur pasojat e një problematike të cilën ne sot e kemi këtu shpresojmë që ne të kemi takat sado të vogël që me qene në hapë me përpjekjet e botes që mos me ndodhë ajo çka po ndodhë e që është parashikimi sipas një informacioni timin laik që del në 2030 temperatura mesatare e tokës me u rrit për 1,5 C° e që nuk ka ndodhur në një shekull e gjysmë. Ku e gjetet këtë fjalën Besëlidhje prej cilës fjala angleze e përkthyer, kjo është kult i joni mos i përzieni me fjalë të huaja mos ekspertoni se besëlidhje është e jona fjala Besë është diçka që është unike dhe ka përmbajtje unike tonën e nuk besoj që është përkthim prej një fjale angleze.

Ajshe Metaj, PDK - ky projekt siç u pa ka ndërhyrë që nga muaji shkurt faktikisht kjo problematikë nuk është tani por është shumë kaheër emetimi i CO2 dhe gazrave tjera saktësisht ne si Komunë sa mundemi me dhen kontribut në këtë drejtim ndoshta mundemi me pak por në një përqindje me të vogël për vet faktin se shumica e gjërave nuk mvaren prej neve dhe faktikisht është problem global por sa ne jemi të përkushtuar dhe çka mund të ndikojmë ne zvogëlimin e përqindjes së CO2 duke i marr parasysh disa sektor të imitimit të CO2 konkretisht është sektori i energjisë i cili faktikisht të ne e dimë që prodhojmë rrymë nga djegja e lendeve djegëse dhe si rezultat i kësaj djegje emetohet një sasi e madhe e CO2 pastaj edhe të transporti rrugor edhe të disa gjëra të tjera në faktë ne si vend pak a shumë jemi të ekspozuar që lirojmë më shumë CO2 duke pasur parasysh

mënyren e prodhimit të rrymës elektrike. Transporti rrugor është e rëndësishme duke marr parasysh edhe ligjet të cilat lejojnë regjistrimin e veturave më të vjetra së 10 vite duke pasur parasysh se këto vetura nuk mund ta djegin mirë lenden dhe jo vetëm që emitoj sasi të CO2 por emitoj edhe sasi të CO që është edhe helmuese dhe gazrave të tjera që shkaktojnë këto problematika. Rrethe kësaj ne si kom dhe secili si individ me dhen kontributin e tyre në këtë drejtim çka ne mund të bëjmë në këtë drejtim. Emetimi i CO2 është edhe tek lendet djegëse sidomos djegja e qymyrit e ka përqindjen me të madhe të CO2. Në KPF atë ditë me është thënë se të ne në shkollë nuk djeget qymyri as një shkollë nëse është kështu është mirë sa ka statistika nuk e di por është në pyetje që të evitohet djegja e qymyrit por me tepër të bëjë në shprehje si lende djegëse të përdoret druri sepse imton sasi të vogël të DIOKSID-it të karbonit emetimi i CO2 shkon edhe si rezultat i hudhjes së mbeturinave nëpër ujera dhe gjatë tretjes së tyre emitohet një sasi e madhe çka duhet të bëjmë ne si individ që ta reduktojmë. se deri në vitin 2030 statistikat tregojnë të reduktohet për 40% por disa gjëra nuk mund ti lëvizin si sektorin e energjisë etj.

Radoš Repanović, SL – ky është vendim i radhës nga komuna ne do ta përkrahim, ne do ta përkrahim këtë dhe do të kontribuojmë.

Zenel Shatri, LDK - e përkrahi këtë marrëveshje dhe jam për nënshkrimin e saj, ndoshta kemi pasur fat që jemi në këtë projekt për zvogëlimin e CO2 dhe materieve tjera që ndotin ambientin.

Arben Kabashi, PDK - faza e parë është që me e marr vendimin nga kuvendi e faza tjetër është çështje ekspertesh.

Kryesuesi i Kuvendit – hedh në votim:

Kuvendi Komunal unanim vendosi:

Që Propozim – Vendimit për autorizimin e Kryetarit për nënshkrimin e marrëveshjes për klimë dhe energji,

Miratohet unanim.

22 anëtar prezent,

Shqyrtimi i pikës 5

Kryesuesi i Kuvendit - propozon që të vazhdohet me piken e pestë të rendit të ditës Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullores për tatimin në pronë, sqaron rrethe rregullores.

Kuvendi unanim vendosi:

Që të Shpallet në diskutim publik Projekt Rregullorja për tatimin në pronë,

Miraton unanim.

22 anëtar prezent.

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi i Kuvendit - propozon që të vazhdohet me piken e gjashtë të rendit të ditës Miratimi i marrëveshjes për bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë,

Nënkryetar i Komunës – prezanton dhe sqaron, marrëveshjen për bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë

Naim Imeraj, AAK - nuk na u sqarua se në material e kemi vendim për një projekt se kjo marrëveshje është parakusht që mu involvu në një projekt konkret të na sqarohet edhe pak.

Nënkryetar i Komunës - Kjo është një derë hyrëse për zhvillimin e një projekti që do të financohet nga UNDPI-ja që donator përfituese duhet të jetë njëra nga këto komuna me obligim që të bashkëpunojnë edhe me tutje më fushën e fatkeqësive elementare kjo është binifiti që e marrim dhe kjo marrëveshje nuk ka as një kosto buxhetore që kërkohet nga ana e Komunës.

Kuvendi Komunal më 19 vota për, dhe 3 abstenime vendosi:
Miratimi e marrëveshjes për bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e
zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë,
Miraton me shumicë votash.
22 anëtar prezent.

Pasi që nuk pati diskutime të tjera, Kryesuesi shpalli të mbyllur mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:30.

**Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues,
Qaush Balaj**

KUVENDI I KOMUNËS

PROJEKT

RREGULLORE PËR TATIMIN MBI PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2019

NENTOR-2018

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 12.1 pika c), dhe nenit 40 paragrafit 40.2 pika a) të Ligjit për

Vetëqeverisjen Lokale Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe në bazë të nenit 9 paragrafi 1 i Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 2/2018) Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datë:....., miratoi këtë:

RREGULLORE PËR TATIMIN MBI PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2019

Neni 1 Qellimi

Me këtë Rregullore përcaktohen normat tatimore për vitin 2019 për të gjitha kategoritë e pronave të paluajtshme me përjashtim të kategorisë pronë publike brenda kufijve të përcaktuar me dispozitat e nenit 9 të Ligjit për Tatimin në Pronën e paluajtshme.

Neni 2 Zona Tatimore

Për vitin 2019 zonat tatimore dhe nivelet e vlerave për M² në Komunën e Istogut, caktohen si vijon:

Kategoria e Vlerës	Nivelet e vlerave për M²			
Zonat tatimore	Zona I	Zona II	Zona III	Zona IV
1.Pronë rezidenciale				
SHTËPI FAMILJARE	250	200	180	150
APARTAMENT	300	250	180	150
GARAZH PËR SHFRYTËZIM PRIVAT	150	120	100	80

OBJEKT TJETËR REZIDENCIAL	100	80	60	40					
2.Pronë komerciale									
SHITORE	600	500	400	300					
ZYRË	600	500	400	300					
RESTORANT	600	500	400	300					
HOTEL	600	500	400	300					
OBJEKT PËR MAGAZINIM KOMERCIAL	100	80	60	40					
GARAZH KOMERCIAL	100	80	60	40					
PISHINË PËR SHFRYTËZIM KOMERCIAL	100	80	60	40					
FUSHË E HAPUR SPORTIVE	100	80	60	40					
FUSHË E MBYLLUR SPORTIVE	100	80	60	40					
POMPË BENZINE	600	500	400	300					
OBJEKT TJETËR KOMERCIAL	100	80	60	40					
3.Pronë industriale									
FABRIKË	450	400	350	300					
PUNISHTË	450	400	350	300					
OBJEKT PËR MAGAZINIM INDUSTRIAL	100	80	60	40					
OBJEKT TJETËR INDUSTRIAL	100	80	60	40					
4.Njësitë rezidenciale të parcelave									
ZONAT TATIMORE	601	602	603	604	605	606	607		
PARCELË PËR SHITËPI FAMILJARE	30.00	15.00	10.00	16.00	25.00	3.60	2.40		
PËR NDËRTESË APARTAMENTESH	30.00	15.00	10.00	16.00	25.00	3.60	2.40		
PËR OBJEKT TJETËR REZIDENC.	30.00	15.00	10.00	16.00	25.00	3.60	2.40		
5.Njësitë komerciale të parcelave									
ZONAT ATIMORE	601	602	603	604	605	606	607	608	609
PARCELË PËR OBJEKT KOMERCIAL	46.00	23.00	5.00	10.00	3.60	16.00	38.00	24.00	2.40
PARCELË PËR REKREACION KOMERCIAL	46.00	23.00	5.00	10.00	3.60	16.00	38.00	24.00	2.40

PARCELË PËR TRANSPORT KOMERCIAL	46.00	23.00	5.00	10.00	3.60	16.00	38.00	24.00	2.40
6.Njësitë industriale të parcelave									
ZONAT TATIMORE	601		602	603	604	605	606	607	
PARCELË PËR INDUSTRI	30.00		15.00	3.40	16.00	20.00	1.40	0.65	
PARCELË PËR IMPIANT ELEKTRIK	30.00		15.00	3.40	16.00	20.00	1.40	0.65	
GROPË ZHAVORRI	30.00		15.00	3.40	16.00	20.00	1.40	0.65	
7.Njësitë bujqësore të parcelave									
ZONAT TATIMORE	601		602		603		604		
FUSHË	4.00		1.40		2.50		0.65		
KULLOSË	2.80		0.95		1.70		0.45		
LIVADH	3.20		1.10		2.00		0.50		
PEMISHTË	4.00		1.40		2.50		0.65		
VRESHTË	4.00		1.40		2.50		0.65		
8.Njësitë Objektet bujqësor									
ZONAT TATIMORE	601		602		603		604		
OBJEKT BUJQËSOR PËR GJËNË E GJALLË	100.00		50.00		60.00		30.00		
AHUR/KOTEC	90.00		40.00		50.00		30.00		
HURDHË PESHQISH	140.00		100.00		110.00		75.00		
OBJEKT TJETËR BUJQESOR	90.00		40.00		50.00		30.00		
9.Njësitë pyjore te parcelave									
ZONAT TATIMORE	601			602		603			
PARCELË PYJORE;	6.50			2.50		0.50			
PARCELË PYJORE- MALORE	0.65			0.25		0.10			

Neni 3

Zonat tatimore

Zona I

Zona e parë përfshinë të gjitha objektet që gjenden në pjesën urbane të qytetit të Istogut duke filluar nga qendra dhe përfshinë rrugët: “Fadil Ferati”, “UÇK”, “2 Korriku”, “Zahir Pajaziti”, “Fehmi Agani”, “Berati”, “Tirana”, “Gazmend Zajmi”, “Hajzer Hajzeraj”, “Hasan Prishtina”, “Rexhë Destani”, “Rinia”, “Lidhja e Prizrenit”, “Gashi i Gurit”, “Edit Durham”, “Ibrahim Rugova”, “Esat Stavileci”, “Skenderbeu”, “Dëshmorët Dërvishaj”, “Bajram Gashi”, “Bujar Visoqi”, “Nënë Tereza”, “Arben Januzaj”, “Oso Kuka”, “Burimi”, “Niman Shabani”, “20 Qershori”, “Mullinjët e Istogut”, “Riza Blakaj”, “Drita e Parë”, “Demush Blakaj”, “Fahredin Bytyçi”, “Ismet Gucia”, “Idriz Saka”, “Sadik Rexha”, “Shaban Manaj”, “Liria”, “Elez Selmanaj”, “Smajl Gusturanaj”, “Bajram Gusturanaj”, “Selim Bajramaj”.

Zona II

Zona e dytë përfshinë të gjitha objektet të cilat janë jashtë zonës së parë të qytetit të Istogut dhe përfshinë periferinë në këto rrugë: “Hysen Bujupi”, “Selim Bajramaj”, “Kongresi i Manastirit”, “Shaban Beka”, “Niman Halili”, “Dheu i Bardhë”, “Jakup Ferri”, “Spanja”, “Mbreti Gent”, “Ali Neziri”, “Hasan Halili”, “Çamëria”, “Ramë Alihajdaraj”, “Kadri Keqa”, “Blini”, “Arif Syla”, “Hasan Alia”, “Faik Konica”, “Llapi”, “Ismail Bajra”, “Dëshmorët e Kombit”, “Arif Halili”, “Mustafë Blakaj”, “Demir Llulla”, “Arben Januzaj”, “Shkoza”, “Kaliqani”, “Pisha”, si dhe objektet në Qendrën Urbane Banjë: “Rilindja Kombëtare”, “Esat Morina”, “Vëllezërit Zeqiraj”, “10 Dhjetori”, “Liria”, “12 Qershori”, “7 Shtatori”, “Rozafa”, “Onixi”, “Abetarja”, “Daut Zagraxha”, “Arbëri”, “Rexhep Maksutaj”, “Rexhep Podrimaj”, “Xhemail Camaj”, “Ahmet Rugova”, “Mehmet Gjevori”, “Arif Ademi”, “Lidhja e Pejës”, “Nimon Elshani”, “Mësuesi Bajram”, “Bardh Isufi”, “Mujë Dreshaj”, “Selim Elshani”, “Myrvete Maksuti”, “Bregu i Ilixhes”, “Termali”, “Sadri Kabashi”, “Isuf Gërvalla”, “28 Nëntori”, “Rozhaja”, objektet në Qendrën Urbane Gjukurac: “Podguri”, “Lidhja e Pejës”, “Mentor Dërvishaj”, “Hasan Podrimaj”, “Besim Kabashi”, “Zejtarëve”, “Kurbini”, “Dëshmorët e Kombit”, “Veteranët e Arsimit”, “7 Marsi”, “Xhafer Mehmetaj”, “Brahim Uka”, “Gurra e Kocit”, “Smail Kabashi”, “Nimon Kabashi”, “Smail Meta”, “Sylë Ferati”, “Sokol Gega”, objektet në Qendrën Urbane Vrellë: “Mbretëresha Teutë”, “Bajram Taku”, “Nimon Demaj”, “Shaban Isufi”, “Sylë Dreshaj”, “Ismet Bicaj”, “Lugu i Madh”, “Djemtë e Vrellës”, “Nezir Mujaj”, “Smail Fetahaj”, “Muharrem Vuthaj”, “Dardania”, “Zeqir Ademi”, “Xhemail Blakaj”, “Dëshmorët Çetaj”, “Binak Rama”, “Feriz Blakaj”, “Amerika”.

Zona III

Zona e tretë përfshinë objektet në këto fshatra të Komunës së Istogut: Banja e Kërrninës, Banjicë, Belicë, Bellopojë, Carrallukë, Cerrcë, Dobrushë, Dragolec, Drejë, Dubovë e Vogël, Gjukurac (jashtë zonës urbane), Kaliqan (pjesa e ulët), Kashicë, Kërrninë, Kovragë, Llugë, Llukac i Thatë, Llukac i Begut, Lubovë, Lubozhdë, Muzhevinë, Orrobërdë, Osojan, Prekallë, Prigodë, Rakosh, Sinajë, Staradran, Studenicë (pjesa e ulët), Tomoc, Trubuhoc, Uçë (pjesa e ulët), Veriq, Vrellë (jashtë zonës urbane), Zallq.

Zona IV

Zona e katërt përfshinë objektet në fshatrat rurale të Komunës së Istogut: Cërkolez, Kaliqan (pjesa e lartë), Kosh, Mojstir, Shalinovicë, Shushicë, Studenicë (pjesa e lartë), Suhugerrllë, Tuçep, Uçë (pjesa e lartë), Zhakovë.

Neni 4 Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi i Komunës së Istogut cakton normat tatimore për vitin 2019 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

KATEGORIA E PRONËS	NORMA TATIMORE
PËR NJËSITË BUJQËSORE TË PARCELAVE	0,15 %
PËR NJËSITË BUJQËSORE TË OBJEKTEVE	0,15 %
PËR NJËSITË PYJORE TË PARCELAVE	0,15 %
PËR NJËSITË REZIDENCIALE TË PARCELAVE	0,15 %
PËR NJËSITË REZIDENCIALE TË OBJEKTEVE	0,15 %
PËR NJËSITË KOMERCIALE TË PARCELAVE	0,15 %
PËR NJËSITË KOMERCIALE TË OBJEKTEVE	0,20 %
PËR NJËSITË INDUSTRIALE TË PARCELAVE	0,15 %
PËR NJËSITË INDUSTRIALE TË OBJEKTEVE	0,20 %

Neni 5 Shfuqizimi

Kjo Rregullore shfuqizon Rregulloren Nr.4/2017 të datës 31.07.2017 për vendosjen e tatimit në pronën e paluajtshme.

Neni 6 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës dhe do të filloj së zbatuari nga 1 janari 2019.

**Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA**



Republika e Kosovës
Republika Kosova



Komuna e Istogut
Opstina Istok

Projekt propozim-Plani i punës së Kuvendit Komunal në Istog për vitin 2019^{synimi}

Me këtë Planë synohet që Kuvendi Komunal të jetë sa më funksional në realizimin e kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin dhe aktet tjera nënligjore.

Objektivat

Kuvendi Komunal në Istog si organ përfaqësues dhe vendim-marrës i Komunës para së gjithash ka për objektiv ndërtimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit në mes Kuvendit dhe Ekzekutivit, qytetarëve dhe grupeve të interesit, organeve të pushtetit qendror dhe atë ndërkomunale, funksionimin sa më normal dhe efikas të Kuvendit sipas mandatit dhe përgjegjësi që ka, zhvillimin e demokracisë së brendshme, transparencës dhe kontrollit e mbi të gjitha respektimin dhe zbatimin e Kushtetutës dhe të gjitha ligjeve si derivat i saj si dhe miratimin dhe harmonizimin e të gjitha akteve normative Komunale me ligjet në fuqi me interes të përgjithshëm.

Qëllimi

Ky plan ka për qëllim informimin e drejtë dhe me kohë të të gjitha institucioneve komunale, organeve qendrore, qytetarëve, organizatave joqeveritare dhe çdo grupi të interesit lidhur me punën dhe aktivitetet e Kuvendit Komunal, Komiteteve dhe trupave tjerë ndihmës të kuvendit që mundëson realizimin e të drejtës të të gjitha grupeve të interesit të jenë akter serioz në vendimmarrje dhe të kenë ndikim në ngritjen transparencës, përgjegjësisë, cilësisë dhe efikasitetit në punë të të gjitha organeve të Komunës.

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data	
Janar	1. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2018. 2. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2018. 3. Shpallja në diskutim publik i Projekt – Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba. 4. Shqyrtimi i Raportit të punës të Kryetarit për vitin 2018. 5. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së prokurimit për vitin 2018.	29/01/2019	1. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2018. 2. Shqyrtimi i Raportit të punës të Kryetarit për vitin 2018. 3. Shpallja në diskutim publik i Projekt – Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba. 4. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2018. 5. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së prokurimit.	21/01/2019	1. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2018 2. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2018. 3. Shqyrtimi i Raportit të punës i Zyrës për Komunitete për muajin janar 2018.	22/01/2019	

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data	
Shkurt	Mbledhje Solemne e Kuvendit Komunal me rastin e 11 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. 1. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për bartjen dhe shpërndarjen e mjeteve nga lista e projekteve kapitale nga viti fiskal 2018 në vitin 2019. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt –Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba. 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të NP."Ambienti" 4. Shpallja në diskutim publik i plotësim ndryshim Rregullores për ndarjen e bursave 5. Hartimi i strategjisë për vitin 2019-2021 të Grupit të Grave Asamblistë. 6.Shqyrtimi dhe miratimi i	17.02.2019 28/02/2019	1. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për bartjen dhe shpërndarjen e mjeteve nga lista e projekteve kapitale nga viti fiskal 2018 në vitin 2019. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt –Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba. 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të NP."Ambienti" 4. Shpallja në diskutim publik i plotësim ndryshim Rregullores për ndarjen e bursave 5. 5. Hartimi i strategjisë për vitin 2019-2021 të Grupit të Grave Asamblistë.?? 6. .Shqyrtimi dhe miratimi i planit zhvillimor I DKA	19.02.2019	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt – Rregullore s për taksa, ngarkesa dhe gjoba. 2. Shqyrtimi i Raportit të punës i Zyrës për Komunitete për muajin shkurt 2019.	20/02/2019	

	planit zhvillimor I DKA						
Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data	
Mars	1. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për vitin fiskal 2018. 2. Shqyrtimi i Raportit të punës për 6 muor të NK."Stacioni i Autobusëve" 3.Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim ndryshim Rregullores për ndarjen e bursave 4.Marrje e vendimit për formimin e Komiteteve Konsultative	28.03.2019	1. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për vitin fiskal 2018. 2. Shqyrtimi i Raportit të punës për 6 muor të NK."Stacioni i Autobusëve" 3. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim ndryshim Rregullores për ndarjen e bursave 4.Marrje e vendimit për formimin e Komiteteve Konsultative	20.03.2019	1. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për vitin fiskal 2018. 2. Shqyrtimi i Raportit të punës i Zyrës për Komunitete për muajin mars 2019.	21/02/2019	

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data	
Prill +	1. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë të vitit 2019. 2. Shpallja në diskutim publik Projekt-Rregullores për të drejtat e fëmijëve 3. Shqyrtimi dhe shpallja në diskutim publik I rregullorës për hapjen e kutisë së ankesave në institucionet edukativo arsimore*shkolla*	29.04.2019	1. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë të vitit 2019. 2. Shpallja në diskutim publik Projekt-Rregullores për të drejtat e fëmijëve 3. Shqyrtimi dhe shpallja në diskutim publik I rregullorës për hapjen e kutisë së ankesave në institucionet edukativo arsimore*shkolla*	22.04.2019	1. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë të vitit 2019. 2. Shqyrtimi i Raportit të punës i Zyrës për Komunitete për muajin prill 2019. 3.Shqyrtimi dhe shpallja në diskutim publik I rregullorës për hapjen e kutisë së ankesave në institucionet edukativo arsimore*shkolla*	23/04/2019	

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data	
Maj	1. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për përgatitjen e strategjisë Antikorrupcion në fushën e prokurimit. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për të drejtat e fëmijëve 3. Shqyrtimi dhe miratimi i rregullorës për hapjen e kutisë së ankesave në institucionet edukativo arsimore*shkolla* 4. Njoftimi me Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore	29.05.2019	1. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për përgatitjen e strategjisë Antikorrupcion në fushën e prokurimit. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për të drejtat e fëmijëve 3. Shqyrtimi dhe shpallja në diskutim publik i rregullorës për hapjen e kutisë së ankesave në institucionet edukativo arsimore*shkolla* 4. Njoftimi me Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së kornizës Afatmesme Buxhetore	21.05.19	1. Shqyrtimi i Raportit të punës i Zyrës për Komunitete për muajin maj 2019. 2.Shqyrtimi dhe shpallja në diskutim publik i rregullorës për hapjen e kutisë së ankesave në institucionet edukativo arsimore*shkolla* 3. Njoftimi me Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së kornizës Afatmesme Buxhetore 2020-1022	22/05/2019	

	2020-1022		2020-1022				
Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data	
Qershor	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2020-2022 2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për rishikimin e buxhetit. 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Strategjik për Zhvillim Komunal. 4. Raportimi i Kryetarit lidhur me zbatimin e Rregulloreve të miratuara nga Kuvendi Komunal. 5.Marrja e Vendimit për vizitë studimore ne Shqipëri	27.06.2019	1. Dëgjimi publik me qytetarë i Kornizës Afatmesme buxhetore 2020-2022 ? 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2020- 2022 ? 2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për rishikimin e buxhetit. 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Strategjik për Zhvillim Komunal . 4. Raportimi i Kryetarit lidhur me zbatimin e Rregulloreve të miratuara nga Kuvendi Komunal. 5.Marrja e Vendimit për vizitë studimore ne Shqipëri	18.06.2019	1. Raporti mbi realizimin i procesit të kthimit. 2. Shqyrtimi i Raportit të punës i Zyrës për Komunitete për muajin qershor 2019. 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2020-	19/06/2019	

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data	
Korrik	1. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2019. 2. Shqyrtimi i raportit për 6 mujorë të punës së Kryetarit të Komunës, 3. Shqyrtimi i raportit të punës për 6 mujorin e NP “Ambienti” 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit dhe analiza e vitit shkollor 2018-2019. 5. Shqyrtimi i Raportit 6-mujor të punës së Komitetit të Auditimit. 6. Raporti 6-mujor i punës së zyrës së prokurimit. 7. Shpallja ne diskutim publik i Projekt - rregullores për tatimin në pronë	29.07.2019	1. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2019. 2. Shqyrtimi i raportit për 6 mujorë të punës së Kryetarit të Komunës, 3. Shqyrtimi i raportit të punës për 6 mujorin e NP “Ambienti” 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit dhe analiza e vitit shkollor 2018-2019. 5. Shqyrtimi i Raportit 6-mujor të punës së Auditorit të Brendshëm 6. Raporti 6-mujor i punës së zyrës së prokurimit. 7. Shpallja në diskutim publik e Projekt – Rregullores për tatimin në pronë.	19.07.2019	1. Shqyrtimi i Raportit të punës i Zyrës për Komunitete për muajin qershor 2019. 2. Shpallja ne diskutim publik i Projekt -rregullores për tatimin në pronë	19/07/2019	

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data	
Gusht	Pushim	Pushim	Pushim	Pushim	Pushim	Pushim	
Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data	
Shtator	1. Dëgjimi publik i Draft Buxhetit Komunal për vitin 2020-2022. 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2020-2022 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt rregullores për tatimin në pronë 3. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2018 dhe miratimi i PV për eliminimin e të metave të rekomanduara nga AP.	13.09.2019 26.09.2019	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Buxhetit për vitin 2020-2022 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt rregullores për tatimin në pronë 3. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2018 dhe miratimi i PV për eliminimin e të metave të rekomanduara nga AP.	19.09.2019	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft 'Buxhetit për vitin 2020-2022 dhe Draft-Rregullores për vendosjen e tatimit në pronë. 2. Shqyrtimi i Raportit të punës i Zyrës për Komunitete për muajin shtator 2019. 3.Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt rregullores për tatimin në pronë	20/09/19	

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data	
Tetor	1. Shqyrtimi i raportit financiar për 3 mujorin e tretë (korrik-shtator)të vitit fiskal 2019. 2. Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2020.	29.10.2019	1. Shqyrtimi i raportit financiar për 3 mujorin e tretë të vitit fiskal 2019. 2. Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2020.	21.10.2019	1. Shqyrtimi i Raportit të punës i Zyrës për Komunitete për muajin tetor 2020.	22/10/2019	

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data	
Nëntor	1. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për themelimin Komitetit konsultativ për çështje të zhvillimit ekonomik. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft- Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019.	29.11.2019	1. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për themelimin Komitetit konsultativ për çështje të zhvillimit ekonomik. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft- Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019.	21.11.2019	1. Shqyrtimi i Raportit të punës i Zyrës për Komunitete për muajin nëntor 2019. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft- Planit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019.	22/11/2019	

